



РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ТРУД И СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА



Në bazë të nenit 158 dhe 159 nga Ligji për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e RM, nr. 79/2009, 36/2011, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 72/15, 104/15, 150/15, 173/15. 192/15 dhe 30/16) dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për shoqatat e qytetarëve për kryerjen e punëve të caktuara në sferën e mbrojtjes sociale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 24/05 dhe 38/07), **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale**, shpallë

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhjen e shoqatës që do të sigurojë shërbimin e mbrojtjes sociale jashtëinstitucionale – jetesë e organizuar me përkrahje për personat me pengesa në zhvillimin mental të moshës mbi 18 vjeç në 17 njësi banesore për jetë të organizuar me përkrahje, prej të cilave 8 në Qytetin e Shkupit dhe 9 në Negotinë me përkrahje të përhershme apo të përkohshme nga persona kompetentë apo të tjerë.

1. Qëllimi i përgjithshëm:

Sigurimi i jetesës së organizuar me përkrahjen në bashkësi banesore të personave me pengesa në zhvillimin mental të moshës mbi 18 vjeç, përmes përkrahjes në përmbushjen e nevojave themelore jetësore, socializim dhe integrim të shfrytëzuesve në bashkësi.

2. Aktivitetet

- sigurimi i kushteve hapësinore për të jetuar të organizuar me përkrahje dhe pajisja e tyre;
- përkrahje në përmbushjen e nevojave themelore jetësore, siç janë: banimi, ushqimi, mirëmbajtja e higjienës personale, sigurimi i veshmbathjes, larja e veshmbathjeve, përkujdesja ndaj shëndetit, kryerja e aktiviteteve të punës, ndihmë gjatë punësimit dhe aktivitete tjera për aftësimin e tyre për të jetuar të pavarur apo për të jetuar me mbështetje;
- vlerësimi dhe përcaktimi i nivelit të përkrahjes në pajtim me nevojat individuale të secilit shfrytëzues dhe përpilimi i Planit për punë individuale me shfrytëzuesin.
- mbështetje për mbrojtjen shëndetësore;
- mbështetje për aktivitetet për organizimin e kohës së lirë;
- mbështetja në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë respektivisht komunikim dhe socializim në grup dhe jashtë tij;
- mbështetje në punësim dhe përsosjes në punë;
- përkrahja psiko-sociale; dhe
- përkrahje për vetpërcaktim dhe vetëpërfaqësim përmes zhvillimit të shkathtësive për aftësimin e shfrytëzuesve të marrin vendime në lidhje me jetën e tyre;

3. Kriteret për pjesëmarrje

- përvojë në punë me personat me pengesa në zhvillimin mental;
- resurse të disponueshme hapësinore, njerëzore dhe teknike dhe
- të mos kishin fituar mjete apo të mos kishin parashtruar fletëparaqitje për fitimin e mjeteve nga ndonjë organ në organ tjetër shtetëror për qëllimin e njëjtë dhe aktivitete për të cilat parashtrojnë fletëparaqitje.

4. Dokumentet e nevojshme

- fletëparaqitje;
- propozim-projekti me përshkrim detal të aktiviteteve me plan pune konkret për implementim dhe periudha e realizimit të projektit, me të cilat do të sigurohet realizimi i qëllimeve të parapara, aktivitetet dhe shërbimet e definuar në konkursin publik;
- numri i Regjistrimit dhe numri i aktvendimit të shoqatës, i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale;
- emri i plotë dhe adresa e subjekteve tjera, me aktivitete të definuar qartë gjatë realizimit të projektit;
- përshkrim detal i aktiviteteve me plan konkret pune për implementimin e të njëjtit dhe periudha e realizimit të projektit, me të cilat do të sigurohet realizimi i qëllimeve të parapara, aktivitetet dhe shërbimet e definuar në konkursin publik;
- strukturë financiare detale e aktiviteteve në kuadër të mjeteve të përgjithshme që parashihen për realizimin e projektit;

- numri i llogarisë transaktive të shoqatës së qytetarëve;
- lista me emër dhe mbiemër për personat që do të angazhohen në realizimin e projektit, si dhe struktura e tyre kualifikuese dhe përvoja e tyre profesionale (biografia e personave);
- emri, mbiemri dhe numri i telefonit i personit përgjegjës për realizimin e projektit;
- informata për përvojën e punës në sferën e mbrojtjes sociale, në pajtim me kërkesat dhe nevojat e konkursit publik;
- deklaratë se nuk kanë fituar mjete financiare për këtë qëllim nga organet tjera shtetërore.

5. Lartësia dhe mjetet që do ta ndahen dhe periudha kohore në të cilën do të kryhen punët

- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do të sigurojë përkrahje financiare në shumë prej 18.000.00 denarë në muaj për një shfrytëzues, për periudhën prej 01.01.2017 deri më 31.12.2017 për maksimum 81 shfrytëzues në njësitë banesore për jetesë të organizuar me përkrahje në Qytetin e Shkupit dhe Negotinë.
- Numri i bashkësive banesore dhe i shfrytëzuesve do të përcaktohet me Marrëveshjen e lidhur midis Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe shoqatës së zgjedhur qytetare dhe e njëjta mund të rritet vetëm me pëlqimin paraprak të marrë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, respektivisht me Aneks të Marrëveshjes.
- Në propozim-projektin duhet domosdo të shënohet shuma dhe lloji i mjeteve që do t'i sigurojë shoqata e qytetarëve për implementimin e Projektit.

6. Përzgjedhja e Projektit më të mirë

- Përzgjedhja do të kryhet në pajtim me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për ndarjen e mjeteve shoqatave të qytetarëve për kryerjen e punëve të caktuara nga sfera e mbrojtjes sociale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 24/05/ dhe 38/07);
- Do të konsiderohet si përparësi nëse sigurohet bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale në sferën e mbrojtjes sociale për këtë kategori të qytetarëve.

Shënim: Fletëparaqitjet me dokumentacion jo të plotë nuk do të shqyrtohen.

7. Afatet për zbatimin e procedurës

- Konkursi zgjattë 5 ditë nga dita e publikimit;
- Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është deri në orën 16 të ditës së fundit të konkursit;
- Komisioni për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve do t'i përgatitë mendim Ministrisë;
- Ministri i Punës dhe Politikës Sociale në afat prej 15 ditëve pas dorëzimit të mendimit nga Komisioni për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve, sjell aktvendim për ndarjen e mjeteve dhe me shkrim do t'i informojë të gjithë aplikuesit për rezultatin përfundimtar;
- Marrëveshjen për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë në realizimin e përkrahjen financiare të shoqatës së qytetarëve, ministri i Punës dhe Politikës sociale do ta lidhë në afat prej 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit për ndarjen e mjeteve dhe fletëparaqitja dhe dokumentet tjera duhet të dorëzohen në Arkiv apo me postë, në këtë adresë: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, rr. Dame Gruev, nr. 14 – Shkup – Komisioni për gjedhjen e shoqatës që do të sigurojë shërbimin e mbrojtjes sociale jashtëinstitucionale – jetesë e organizuar me përkrahje për personat me pengesa në zhvillimin mental të moshës mbi 18 vjeç në 17 njësi banesore për jetë të organizuar me përkrahje prej të cilave 8 në Qytetin e Shkupit dhe 9 në Negotinë me përkrahje të përhershme apo të përkohshme nga persona kompetentë apo të tjerë.

Shoqatat që do të përkrahen nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kanë për obligim që në të gjitha materialet (të shtypura apo në formë elektronike) që do të prodhohen në kuadër të këtij projekti, në vend të dukshëm duhet të qëndrojnë:

I përkrahur nga:



**Republika e Maqedonisë
MINISTRIA E PUNËS DHE
POLITIKËS SOCIALE**